



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1697/4 prot.

Datë 03.08.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 719/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.08.2023 shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Alb Garden” SHPK për procedurën “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-74343-07-05-2023, me objekt “Blerje pemë dekorative për Pyllin Orbital dhe zona të ndryshme të Tiranës”, me fond limit 59,500,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 07.08.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës

**Ankimues:** “Alb Garden” SHPK  
*Adresa: Lagjja “Skënderbeg, godinë private 1 katëshe, Superstrada Lezhë-Shkodër, Lezhë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.  
*Adresa: Rruga “5 Maji”, Tiranë*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.07.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-74343-07-05-2023, me objekt “Blerje pemë dekorative për Pyllin Orbital dhe zona të ndryshme të Tiranës”, me fond limit 59,500,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 07.08.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.

II.2. Në datën 14.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ankesa e operatorit ekonomik “Alb Garden” SHPK, me numër ankimi elektronik A/2023/3270, protokolluar me nr. 1697/2023 prot., datë 14.07.2023, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën me Nr. 1207/10 prot., datë 21.07.2023 protokolluar me tonën me nr.1697/2 prot., datë 24.07.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5 Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, duke pranuar *pretendimin lidhur me pikën 1 të ankesës (saktësimi i artikujve të cilët nuk figurojnë në shtojcën 6)*, është pranuar *pretendimi lidhur me pikën 3 të ankesës (pikën 2.3.4 kapaciteti teknik të dokumenteve standarde të tenderit në lidhje me uljen e numrit të punëtorëve nga 49 punonjës në 25 punonjës)*, është pranuar *pretendimi lidhur me pikën 4 të ankesës (duke e hequr kriterin për punonjës në lartësi)*.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën me Nr. 1207/10 prot., datë 21.07.2023 protokolluar me tonën me nr.1697/2 prot., datë 24.07.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit..

II.5 Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, duke pranuar *pretendimin lidhur me pikën 1 të ankesës (saktësimi i artikujve të cilët nuk figurojnë në shtojcën 6)*, është pranuar *pretendimi lidhur me pikën 3 të ankesës (pikën 2.3.4 kapaciteti teknik të dokumenteve standarde të tenderit në lidhje me uljen e numrit të punëtorëve nga 49 punonjës në 25 punonjës)*, është pranuar *pretendimi lidhur me pikën 4 të ankesës (duke e hequr kriterin për punonjës në lartësi)*.

II.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-74343-07-05-2023, me objekt “Blerje pemë dekorative për Pyllin Orbital dhe zona të ndryshme të Tiranës” me fond limit 59,500,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 07.08.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.
  2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
  3. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Kryetar**

**Jonaïd Myzyri**

